

VENDIM
Nr. 463, datë 27.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 34, DATË 7.1.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE DHE
TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË
SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2015 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE
QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i dytë, i pikës 15, të vendimit nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“DSHQ-ja u vë në dispozicion mjedise pune ish-presidentëve, pa pagesë. Ajo mbulon shpenzimet për shërbime sekretarie, pastrimi dhe mirëmbajtjeje mjedisi, shpenzimet për energji elektrike, ujë, telefoni fikse (përfshirë dhe internet), në masën sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në buxhetin e vitin 2015 të shtohet fondi prej 15 159 165 lekë (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, përkatësisht, vlera 1 302 000 (një milion e treqind e dy mijë) lekë në zërin “Shpenzime korente” dhe vlera 13 857 163 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë në zërin “Investime”.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2015.

4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI NR. 1

Për ish-presidentët, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare përballon këto shpenzime:

1. Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e zyrave.
2. Për mbajtjen e personelit të nevojshëm, e konkretisht sekretare (një për secilën zyrë) dhe një punonjëse pastrimi për të gjitha zyrat.
3. Shpenzimet për energji elektrike 20 000 lekë/në muaj për zyrë, çdo shpenzim mbi këtë kuotë të mbulohet nga vetë ish personalitetet që do të përfitojnë këtë shërbim.
4. Shpenzimet për konsumin e ujit 2000 lekë në muaj për zyrë, çdo shpenzim mbi këtë kuotë të mbulohet nga vetë ish personalitetet që do të përfitojnë këtë shërbim.
5. Shpenzime për internet e shpenzimet bazë për telefoninë fikse kuota 3 000 lekë në muaj për zyrë, çdo shpenzim mbi këtë kuotë të mbulohet nga vetë ish personalitetet që do të përfitojnë këtë shërbim.